



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:259289

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05558262

C.nr.854/2023

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Artan Abazi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, R.M. ngatë cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Spahiu, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, me objekt kontesti padi për kompensimi i shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fund vitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, jashtë seancës, me datë 29.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. M. nga dhe **DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fund vitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, për vitin 2021, t’ia paguaj paditësit shumën e të hollave në lartësi prej 638.51 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 14.11.2023, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës, në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi më datën 14.11.2023 ndaj të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, për kompensimi i shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore si dhe benficineve tjera.

Në përmbajtjen e padisë ka theksuar se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me afat të pacaktuar, në orar të plotë të e paditura, në vendin e punës Zyrtar Patrollues në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës, ku vazhdon punën edhe sot, ndërsa bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të datës 14.11.2018, të njëjtit i takojnë shpenzimet për shujtë ditore për ditët e pranisë në punë dhe shpërblimi për pagat mujore ekuivalente me pagën e fund vitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për taksën gjyqësore dhe për përpilimin e padisë, gjithsej shumën e përgjithshme prej 125 euro.

Gjykata, në këtë çështje juridike kontestuese pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura, në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në padi, duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Ka shtuar se paga e 13 të mund të kërkohej pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, po ashtu ka shtuar edhe pagën e shujtave e ka kundërshtuar për arsye se vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore dhe buxhetore andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim dhe detyrim ndaj të paditurës.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, e as gjendjen faktike, por vetëm është thirrur në mungesë të mjeteve buxhetore, andaj gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, si dhe nenin 399 të LPK-së ku parashihet se: *Kur gjykata pasi ti arrijë përgjigje në padi konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, fakt ky i cili vërtetohet nga Vërtetimi me nr. të ref.DDK-05/563/2021 të datës 07.05.2021, nuk është kontestueses fakti se i njëjti gjatë vitit 2021 ka marrë pagë bruto në shumë prej 638.51 euro, fakti ky i vërtetuar nga lista e pagave në emër të paditësit lëshuar nga buxheti i Republikë së Kosovës, nuk është kontestues se i njëjti gjatë vitit 2021 është vlerësuar me performancë të kënaqshme.

Bazuar në nenin 329, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), që përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, gjykata i mori të besueshme provat e bashkëngjitura nga paditësi, si vërtetimin mbi pagën, formularin për performancë, listën e pagave gjatë tri viteve të lëshuara nga buxheti i Republikës së Kosovës, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga organi shtetëror, këtu vetë e paditura.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës, që përcakton se *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*; nenin 55, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 se *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*; pika 2 e këtij se *“Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”*; si dhe nenin 29, paragrafi 2 ku përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj t’ia paguajë pagën e 13-të për çdo fund vit, pasi janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitet 2018, 2019 dhe 2020, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se në rastin konkret nuk janë shterur të gjitha mjetet e brendshme juridike për ankim për gjykatën një pretendim i tillë është i pabazuar pasi që i njeti me kërkesë i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme-Drejtorisë së Përgjithshme për pagesën e pagës së trembëdhjetë.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 datë 19.06.2012.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 104€ dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20 €, e në shumën e përgjithshme prej 124€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.854/2023, më datë 29.02.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2023:259289
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05558262